



INSTITUTI ALBANOLOGJIK - PRISHTINË

INSTITUTI ALBANOLOGJIK PRISHTINE			
Data e dorëzimit: 04.12.2025			
J. Org	Numri	Shtojca	Vlera
IAP	127		

Rr. "E. Çabej", nr: 93. Prishtinë, R. e Kosovës, Tel: +383 38 22 08 22, Tel/Fax: +383 38 224 156
www.instituti.albanologjik.com. [E-mail: instituti.albanologjik@gmail.com](mailto:instituti.albanologjik@gmail.com)

Datë, 04.12.2025

Duke u bazuar në nenin 25, paragrafi 5 të Ligjit Nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore - Shkencore, nenin 23 dhe 27 të Statutit të Institutit Albanologjik - Prishtinë, nenin 2 dhe 17 të Rregullores së Punës së Këshillit Drejtues të Institutit Albanologjik-Prishtinë, Ligji Nr. 05/L - 031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Raportin e Komisionit profesional-Shkencor për zbatimin e procedurës së zgjedhjes së drejtorit Nr.117/2025 i datës 24.11.2025, propozimin e Këshillit Shkencor i datës 27.11.2025, Këshilli Drejtues i Institutit Albanologjik, në mbledhjen e mbajtur më 04.12.2025 mori këtë:

VENDIM

1. Dr. Naim Berisha, zgjedhet drejtor i Institutit Albanologjik.
2. Mandati i drejtorit është katër (4) vjet nga dita e zgjedhjes.
3. Të drejtat, detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit janë të përcaktuara me Ligjin për Veprimtarinë Kërkimore-shkencore, Statutin e Institutit Albanologjik si dhe me aktet tjera ligjore e nënligjore në fuqi.
4. Ky Vendim hynë në fuqi nga dita e nënshkrimit.

Arsyetim

Bazuar në neni 25, paragrafi 5 të Ligjit Nr. 04/L-135 për Veprimtarinë Kërkimore - Shkencore, neni 26, paragrafi 6 të Statutit të Institutit Albanologjik, nenin 2 dhe 17 të Rregullores së Punës së Këshillit Drejtues të Institutit Albanologjik-Prishtinë, Ligji Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Vendimin e Këshillit Drejtues të datës 10.10.2025, pas njoftimit paraprak të MASHTI-t më datë 02.10.2025, Instituti Albanologjik-Prishtinë shpalli Konkurs publik për pozitën e Drejtorit të Institutit Albanologjik. Konkursi është publikuar në Sistemi Informativ për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (SIMBNJ), gazetën Epoka e Re dhe në ueb faqen e Institutit më 14.10.2025. Këshilli Shkencor i Institutit Albanologjik, bazuar në neni 25 paragrafi 2 i Ligjit për Veprimtarinë Kërkimore -Shkencore, neni 27 paragrafi 2 i Statutit të Institutit Albanologjik, në mbledhjen e datës 20.11.2025, ka formuar Komisionin profesional-shkencor për zbatimin e procedurave për zgjedhjen e drejtorit. Komisioni profesional -shkencor i ka zhvilluar të gjitha procedurat dhe ka paraqitur Raportin e vlerësimit për secilin kandidat (me datë: 24.11.2024, me nr. Protokolli Nr.117/2025, datë, 24.11.2024) dhe në bazë të nenit

25 paragrafi 4 të LVKSH-së, nenit 27 paragrafit 5 të Statutit të Institutit Albanologjik dhe nenet 2, 10, 11 dhe 12 të Rregullores së Punës së Këshillit Shkencor të Instituti Albanologjik, Këshilli Shkencor më datë 27.11.2025, ka miratuar Raportin e Komisionit dhe i ka propozuar Këshillit Drejtues të Institutit Albanologjik kandidatet për drejtor të Institutit.

Këshilli Drejtues i Institutit Albanologjik, në mbledhjen e mbajtur më datë: 04.12.2025, me vota unanime të anëtarëve të pranishme me të drejtë vote, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur mund të ushtrojë ankesë në Komisionin e Ankesave të Institutit Albanologjik-Prishtinë në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi i dërgohet:

- Kandidatit të zgjedhur;
- Kandidatëve për drejtor;
- Administratës së LAP.

Prof. asoc. dr. Meliza Krasniqi

*Ushtruese e detyrës së drejtorit
të Institutit Albanologjik*